



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/112

Datë: 20.08.2021

Procesverbal

i mbledhjes së V (pestë) të rregullt për vitin 2021 e Komitetit për Politikë dhe Financa

RENDI DITËS

1. Shqyrtimi dhe rekomandimi i kërkesës nr.01/404 datë: 03.06.2021 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, sipas kërkesës nr.09/148 datë: 31.05.2021 të Drejtorisë për Shërbime Publike.
2. Shqyrtimi i kërkesave.
3. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 18.06.2021 duke filluar në ora 13:40, morën pjesë 7 anëtarë të KPF-së, zyra për informim.

Rahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve rëndin e ditës e keni a ka dikush diçka?

Alban Krasniqi: Lidhur me disa kërkesa pash që shumë janë të pa kompletuara.

Rahim Morina: Kush jeni për këtë rend të ditës? Unanimisht ishin për.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i dy procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara Unanimisht për miratimin e dy procesverbaleve ishin 6 anëtarë.
2. Shqyrtimi dhe rekomandimi i kërkesës nr.01/404 datë: 03.06.2021 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, sipas kërkesës nr.09/148 datë: 31.05.2021 të Drejtorisë për Shërbime Publike.

Alban Krasniqi: Kërkesa ka shumë probleme në vetvete, ne u patëm pajtuar që në këtë vit pishinën ta menaxhojë Komuna. Unë e kam vizatuar pishinën dhe asnjë prej bizneseve aty që e ka pas atë vend në shfrytëzim asnjë cent se kanë investuar, aty ka nevojë të sanohen disa defekte por është shumë vonë, çka është më e nevojshme janë tualetet, nyet sanitare donë pastruar rëra mu shtru, bari mu pastruar. Unë personalisht s'jam që ne të ndajmë më shumë se 10 mijë euro, sepse aty ku inkasohen mjetet dera aty veq ekziston veç donë lyer pak, ndriçimi ekziston.

Halil Morina: Në parim kërkesa është e domosdoshme me shku në kuvend, sepse e bllokojmë atë proces, ne kemi marrë pare të kaluarën prej biznesit si Komunë e aty nuk është investuar, sepse biznesi nuk investon në tokë të huaj. Ne në Kuvend e diskutojmë kërkesën dhe modalitetet.

Valon Krasniqi: Për kërkesën ne nuk kemi informacion dhe as specifikacion për këtë shumë që ka kërkuar drejtorja, nuk pajtoj me investuar aty, kjo shumë që është kërkuar duhet të arsyetohet, vota ime është kundër.

Hashim Vrenezi: Një kritikë se biznesi është dashtë me kanë nën menaxhim të komunës krejt vitin e jo veç në sezona dhe kush është përgjegjës nëse ndodhë diçka e keqe në Pishinë?

Në buxhet s'është paraparë asnjë investim aty, jam që aty të ndodhë një investim i mirëfillt dhe të parashihet me buxhet. Në kuvend duhet të diskutohet sidomos për stafin që kërkohet aty dhe për ndonjë investim minimal, duhet me tregu ku kanë mi marrë ato mjete.

Rahim Morina: Pishina e Banjës nuk e ka pas tretmanin meritator edhe pse ka pas të hyra, sepse s'është investuar asgjë aty edhe duke pas parasysh se ai vend është atraktiv.

Alban Krasniqi: Në investime të futen infrastrukturë që rrisin sigurinë e pushuesve aty, shuma që është kërkuar është e madhe duhet të kthehet e të parashihet më një shumë të domosdoshme.

Rrahim Morina: Nga DShP kërkojmë që shuma të jetë e domosdoshme, të specifikohet shuma për këtë vit dhe të sigurohen mjetet sidomos dhe të bëhet kulla e vrojtimit të pishina.

Kush jeni të rekomandohet kjo kërkesë? Unanimisht ishin 6 anëtarë për.

3. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa nr.02/278 datë: 02.06.2021 e parashtruar nga z.Adem Hoti nga fshati Çarrallukë për mbështetje financiare për shërim.

Rrahim Morina: Kush jeni që t'i ndahen mjetet në shumën 500 € (pesëqind euro).

Unanimisht ishin 7 anëtarë për.

Kërkesa nr.02/285 datë: 07.06.2021 e parashtruar nga zj.Hidajete Buzhala nga fshati Banjë, për mbështetje financiare për shërim.

Rrahim Morina: Kush jeni që t'i ndahen mjetet në shumën 500 € (pesëqind euro).

Unanimisht ishin 7 anëtarë për.

Kërkesa nr.02/279 datë: 03.06.2021 të parashtruar zj. Bukuriye Kelmendi nga fshati Balincë, për mbështetje financiarë për trajtim shëndetësor.

Andaj Komiteti për Politikë dhe Financa pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, unanimisht përmes shkresë përcjellëse ka vendosur të përcjellë për zyrën e Kryetarit të Komunës për shqyrtim të mëtutjeshëm të kërkesës në fjalë.

Kërkesa nr.02/283 datë: 07.06.2021 e parashtruar nga zj.Shyhrete Vrenezi me vendbanim në fshatin Marali, Komuna e Malishevës për mbështetje financiare për shërim.

Rrahim Morina: Kush jeni që t'i ndahen mjetet në shumën 500 € (pesëqind euro).

Unanimisht ishin 7 anëtarë për.

Kërkesa nr.01/292 datë: 09.06.2021 e parashtruar nga z.Ahmet Paçarizi nga fshati Dragobil Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për shërim.

Rrahim Morina: Kush jeni që t'i ndahen mjetet në shumën 500 € (pesëqind euro).

Unanimisht ishin 7 anëtarë për.

Kërkesa nr.02/290 datë: 09.06.2021 e parashtruar nga zj.Kumri Krasniqi me vendbanim në fshatin Damanek, Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për shërim.

Rrahim Morina: Kush jeni që t'i ndahen mjetet në shumën 500 € (pesëqind euro).

Unanimisht ishin 7 anëtarë për.

Kërkesa nr.02/248 datë: 21.05.2021 e parashtruar nga z.Fazli Gashi nga fshati Ngucat, Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për shërim.

Rrahim Morina: Kush jeni që t'i ndahen mjetet në shumën 500 € (pesëqind euro).

Unanimisht ishin 7 anëtarë për.

Kërkesa nr.02/255 datë: 26.05.2021 të parashtruar nga z. Hafir Morina nga fshati Lubizhdë, Komuna e Malishevës, për trajtim shëndetësor të vajzës së tij Viola Morina.

Rrahim Morina: Komiteti për Politikë dhe Financa pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, unanimisht përmes shkresës përcjellëse ka vendosur të përcjellë për zyrën e Kryetarit të Komunës për shqyrtim të mëtutjeshëm të kërkesës në fjalë.

Kërkesa nr.02/303 datë: 15.06.2021 të parashtruar nga z. Xhemajl Sadikaj nga fshati Panorc, Komuna e Malishevës, për ndihmë financiare për shërim.

Rrahim Morina: Komiteti për Politikë dhe Financa pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, unanimisht përmes shkresës përcjellëse ka vendosur të përcjellë për zyrën e Kryetarit të Komunës për shqyrtim të mëtutjeshëm të kërkesës në fjalë.

Kërkesa nr.02/254 datë: 25.05.2021 të parashtruar nga z. Ruzhdi Zogaj nga fshati Lladroc, Komuna e Malishevës, për trajtim shëndetësor të nënës së tij Have Zogaj.

Rrahim Morina: Komiteti për Politikë dhe Financa pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, unanimisht përmes shkresë përcjellëse ka vendosur të përcjellë për zyrën e Kryetarit të Komunës për shqyrtim të mëtutjeshëm të kërkesës në fjalë.

Kërkesa nr.02/294 datë: 11.06.2021 e parashtruar nga zj.Hanife Hazrolli nga fshati Banjë, Komuna e Malishevës për mbështetje financiare për shërim.

Rrahim Morina: Kush jeni që ti ndahen mjetet në shumën 500 € (pesëqind euro).

Unanimisht ishin 7 anëtarë për.

Kërkesa nr.02/261 datë: 27.05.2021 e parashtruar nga z. Elmi Kryeziu nga fshati Bubavec, Komuna e Malishevës për mbështetje financiare për shërim.

Rrahim Morina: Kush jeni që ti ndahen mjetet në shumën 500 € (pesëqind euro).

Unanimisht ishin 7 anëtarë për.

Kërkesa nr.02/297 datë: 11.06.2021 e parashtruar nga z. Ismet Thaqi dhe z. Hysen Thaqi, nga fshati Carrallukë Komuna e Malishevës, për kthimin e pronës nga NSH "Agroprogres" në Pronë të Komunës së Malishevës.

Rrahim Morina: I përgjigjemi me një shkresë përcjellëse që Komiteti për Politikë dhe Financa lidhur me kërkesën e lartcekur nuk ka marrë ndonjë vendim, pasi që sipas nenit 9 të ligjit Nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës dhe ekzekutivi i komunës nuk mund të merr asnjë vendim lidhur me dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nga dita kur Presidenti shpall zgjedhjet lokale.

Kërkesa nr.02/281 datë: 07.06.2021 të parashtruar nga Femhi Javori nga fshati Llazicë.

Rrahim Morina: Komiteti për Politikë dhe Financa lidhur me kërkesën e lartcekur nuk merr ndonjë vendim, pasi që sipas nenit 9 të ligjit Nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës dhe ekzekutivi i komunës nuk mund të merr asnjë vendim lidhur me dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nga dita kur Presidenti shpall zgjedhjet lokale.

Kërkesa nr.02/262 datë: 27.05.2021 të parashtruar nga z. Milazim Berisha nga fshati Carravranë, Komuna e Malishevës.

Rrahim Morina: Komiteti për Politikë dhe Financa pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, unanimisht përmes shkresë përcjellëse ka vendosur të përcjellë për Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për shqyrtim të mëtutjeshëm të kërkesës në fjalë.

Kërkesa nr.02/276 datë: 02.06.2021 të parashtruar nga z. Daut Bajramaj nga fshati Panorc, Komuna e Malishevës për ndërrimin e paluajtshmerinë.

Rrahim Morina: Komiteti për Politikë dhe Financa lidhur me kërkesën e lartcekur nuk merr ndonjë vendim, pasi që sipas nenit 9 të ligjit Nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës dhe ekzekutivi i komunës nuk mund të merr asnjë vendim lidhur me dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nga dita kur Presidenti shpall zgjedhjet lokale.

Kërkesa nr.02/261 e parashtruar nga Pajtim Gashi nga fshati Kijevë.

Rrahim Morina: këtë kërkesë ja dërgojmë komisionit i cili ka shqyrtuar dhe po shqyrton disa kërkesa të se njëjtës natyre.

Rrahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve, ju falënderoj për pjesëmarrje

Mbledhja përfundoi në ora 16:20

Procesmbajtësi

Naim Avdijaj jur. i dip

